



Datë: 28.04.2025

Numër Protokolli: 2850/2025

A.nr.468/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga Malsore Gashi Bajraktari, kryetare, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Ylber Fetahaj, si procesmbajtëse, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.468/2025, të datës 13.03.2025, të parashtruar nga ankuesit A.I, B.U dhe L.K-B të cilët sipas autorizimit i përfaqëson ankuesi A.I, kundër procedurës së Rekrutimit për pozitën Drejtor i Përgjithshme të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës shpallur nga Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, në çështjen juridike “*Kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 28.04.2025, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e parakohshme ankesa A.nr.468/2025, të datës 13.03.2025, e parashtruar nga ankuesit, A.I, B.U dhe L.K-B të cilët sipas autorizimit i përfaqëson ankuesi A.I.

A r s y e t i m

Ankuesit, A.I, B.U dhe L.K-B të cilët sipas autorizimit i përfaqëson ankuesi A.I (*në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesit*), më datë 13.03.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër procedurës së Rekrutimit për pozitën Drejtor i Përgjithshme të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës të shpallur nga organi i punësimit Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, sipas Konkursit me numër reference RN00016462, më datën 27.01.2025 për pozitën Drejtor i Përgjithshme të Autoritetit të Aviacionit Civil.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (*në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit*) duke ju referuar shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë ka gjetur se ankesa e parashtruar nga ankuesit është e parakohshme, *sepse:*

Nga analizimi i provave të lëndës rezulton se Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, më datë 27.01.2025, ka shpallur konkursin publik me numër të referencës RN00016462, për Drejtor i Përgjithshëm në grupin, Drejtues të lartë, respektivisht, për pozitën Drejtor i Përgjithshme të Autoritetit të Aviacionit Civil, ku afati për aplikim ishte nga data 28.01.2025 deri me datën 26.02.2025

Rrjedhimisht, sipas shkresave të lëndës rezultojnë se ankuesit kanë aplikuar në procedurën përkatëse të rekrutimit, dhe të njëjtit kanë kaluar fazën e verifikimit paraprak dhe kanë marr pjesë në këtë procedure të rekrutimit deri në intervistën me gojë.

Ankuesit, me datën 13.03.2025 në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku ndër të tjera pretendojnë se zyrtarja përgjegjëse e NJMBNJ S.S në AAC ishte në konflikt të intertit me kandidatin B.U të vërtetuar sipas Vendimit të Këshillit me Nr.378/2020 dhe opinionet të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit- AKP, ankuesit kërkojnë që këshilli të anuloi këtë procedure të rekrutimit për pozitën Drejtor i Përgjithshme të Autoritetit të Aviacionit Civil dhe të përjashtojnë nga komisioni zyrtarë e NJMBNJ S.S

Kolegji i Këshillit lidhur me pranueshmërinë e ankesës iu referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, gjegjësisht nenit 39 paragrafi 12 ku përcaktohet se: *12. Kandidatët/ët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK sipas afatit të përcaktuar në ligjin përkatës për procedurën administrative, si dhe nenit 17 të Rregullores Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimiit Në Shërbimin Civil, ku përcaktohet se: 17. Kandidatët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK në afat prej tridhjetë (30) ditëve.*

Referuar kuadrit ligjor përkatës si dhe duke u bazuar në provat e administruara Kolegji i Këshillit konstatoi se ankesa e parashtruar nga ankuesit me datë 13.03.2025, kundër procedurës së Rekrutimit për pozitën Drejtor i Përgjithshme të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës të shpallur nga Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, sipas Konkursit me numër reference RN00016462, me datën 27.01.2025 për pozitën Drejtor i Përgjithshme të Autoritetit të Aviacionit Civil, është e parakohshme, ngase sipas dispozitave përkatëse ligjore, kandidati për pranim në shërbim civil ka të drejtë të parashtoj ankesë vetëm pas përfundimit të procedurës së rekrutimit, ndërsa, në rastin konkret ankuesit kanë parashtruar ankesë ende pa përfunduar procedura e rekrutimit e shpallur sipas konkursit publik me numër të referencës RN00016462 ku në bazë përgjigjes në ankese me datën 24.04.2024 nga organi i punësimit AAC dëshmohej se kjo procedure e konkurrimit ka përfunduar me datën 23.04.2024 duke i shpallur edhe kandidatet fitues.

Andaj, theksuar si më sipër, Kolegji i Këshillit konstaton se ankesa e parashtruar nga ankuesit me datë 13.03.2025, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pa u publikuar ende rezultatet përfundimtare lidhur me procedurën përkatëse të rekrutimit është e parakohshme në kuptim të dispozitave të nenit 39 paragrafi 12 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, ndërlidhur me nenin 127 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe se në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, e njëjta është e papranueshme, kështu që, Kolegji i Këshillit duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi të hedhë poshtë si të parakohshme ankesën A.nr.468/2025, të datës 13.03.2025, siç përcaktohet në dispozitiv të këtij vendimi.

Kolegji i Këshillit thekson faktin se hedhja poshtë e ankesës me numër A.nr.468/2025, nuk e mohon të drejtën e ankuesve, që të kundërshtoj ligjshmërinë e kësaj procedurës së rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare si akt mbi përfundimin e konkursit lidhur me pozitën përkatëse.

Këshillë juridike: Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij Vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.468/2025

Ylber Fetahaj

Procesmbajtës

Malsore Gashi -Bajraktari

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar -Ankuesit, A.I;
- Udhëheqësit të Personelit në Autoritetin të Aviacionit Civil të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.